

Nr. 52 Prot.
dt. 23.07.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË
PËR ARSIMIN, SPORTIN DHE RININË

Nr. 2442 / 3 Prot.

Tiranë, më 19.7. 2021

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë

QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

KOLEGJIT PROFESIONAL TË LARTË, "TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL"

Adresa: Rruga "Gjeneral Nikols", Pallati Shushica, kati 1, Tiranë

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 237, datë 19.7.2021 "Për hapjen e programit të studimit me karakter profesional në "Menaxhimi i SPA-ve dhe Biznesit të Bukurisë", në Kolegjin Profesional "Tirana Esthetics & Style School".

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Alqi KUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2442/2 Prot.

Tiranë, më 19.7. 2021

URDHËR

Nr. 237, Datë 19.7.2021

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË
“MENAXHIM I SPA-VE DHE BIZNESIT TË BUKURISË”, NË KOLEGJIN
PROFESIONAL “TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL”**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 72 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit me karakter profesional në “Menaxhim i SPA-ve dhe Biznesit të Bukurisë” me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë profesionale në “Menaxhim i SPA-ve dhe Biznesit të Bukurisë”, në Departamentin e Estetikë-Nutricionit, në Kolegjin Profesional “Tirana Esthetics & Style School”, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit me karakter profesional në “Menaxhim i SPA-ve dhe Biznesit të Bukurisë”, në Departamentin e Estetikë-Nutricionit, në Kolegjin Profesional “Tirana Esthetics & Style School”, fillon në vitin akademik 2021-2022.
3. Kolegji Profesional “Tirana Esthetics & Style School”, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Kolegji Profesional “Tirana Esthetics & Style School” të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Profesional “Tirana Esthetics & Style School”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI